



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 692 Prot.

Tiranë, më 28.05 2018

**VENDIM Nr. 104, datë 14.05.2018**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), VKM Nr. 280, datë 01.04.2015 "Për përcaktimin e kriterëve, procedurave të dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi në ndërtimet me leje". Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.5 të datës 14.05.2018, pasi shqyrtoi kërkesën e ALUIZNI-it Sarandë për konfirmim nga KKA, për vijimin e procedurës së legalizimit të objektit "Godinë banimi 3 kate" të Z. Agim Skënder Lika, Zona Kadastrale 8641, i cili pozicionohet brenda zonës arkeologjike "B" të qytetit të Sarandës,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë kërkesën e ALUIZNI-it Sarandë për konfirmim nga KKA, për vijimin e procedurës së legalizimit të objektit "Godinë banimi 3 kate" të Z. Agim Skënder Lika, Zona Kadastrale 8641, i cili pozicionohet brenda zonës arkeologjike "B" të qytetit të Sarandës.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

MINISTËR



SEKRETARI I KKA

RUDINA ZOTO

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al